



Adresa: Blvd "Bajram Curri"
Rr: "Viktor Eftimiu", 1023, Tiranë
| web: www.ere.gov.al

02 nëntor 2023

Njoftim

Sqarim në lidhje me Vendimarrjen për Pezullimin e procesit të rinovimit të licencës së shoqërisë "ECO-ELB" sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW;

Në datën 27.09.2023, shoqëria "ECO-ELB" sh.a. brenda afatit prej 6 muajsh të përfundimit të licencës në përputhje dhe me rregulloren e licencimit, paraqiti në ERE kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW.

Në vijim të këtij aplikimi, ndër të tjera, me vendimin Nr. 309 datë 30.10.2023, Bordi i ERE-s vendosi pezullimin e kësaj vendimarrje për rinovimin e licencës së shoqërisë ECO-ELB sh.a. në kushtet që shoqëria aktualisht ka një licencë të vlefshme deri me datën 27.03.2024, dhe duhet të përcjellë në ERE kontratën e rinovuar me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për përdorimin e impiantit të incenerimit për prodhimin e energjisë elektrike, brenda afatit të përfundimit të licencës aktuale.

Aktualisht shoqëria ECO - ELB sh.a. ka një licence prodhimi të energjise elektrike të vlefshme deri më 27.03.2024.